



**MINISTRIA E KULTURËS
DREJTORIA RAJONALE E TRASHËGIMISË KULTURORE
SHKODËR**

Nr. 304/prot.
4

Shkodër më 06.07.2023

SHPLLJE PËR KONKURRIM PUBLIK

Në mbështetje të ligjit nr.7961, date 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.581, date 28.8.2019 “Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore”, në Urdhrit e Kryeministrit nr.139, datë 21.10.2019 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore”, Statutit të Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Shkodër dhe Rregullores për Organizimin dhe Funksionimin e Brendshëm për Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Shkodër;

Drejtoria Rajonale e Trashëgimisë Kulturore Shkodër shpall konkursin për pozicionin vakant:

Përgjegjës sektori në sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse – Kategoria e pagës IV-2.

Përshkrimi i përgjithshëm i punës për këtë pozicion:

- 1.Administron mjetet financiare që i vihen në dispozicion DRTK së sipas planit financiar;
- 2.Mban kontabilitetin financiar dhe bën azhornimin e tij me librat analitikë;
- 3.Përpilon përmbledhësen e listëpagesave si: borderotë, sigurimet shoqërore etj;
- 4.Përpilon dhe paraqet çdo muaj pasqyrat financiare dhe i paraqet pranë institucioneve të përcaktuara shtetërore;

Adresa: Rruga “Marin Beçikemi”, Sheshi “Gjon Pali II”

Tel, Fax : 02 2243409

5. Siguron mbarëvajtjen dhe koordinimin e punës brenda sektorit.
6. Raporton tek eprori dhe në Minisreinë e Kulturës për çdo lëvizje të fondeve buxhetore;

KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT DHE KRITERET E POSAÇME:

Kandidati duhet të plotësojë kushtet për konkurim si vijon:

1. Të jetë shtetas shqiptar;
2. Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
3. Të zotërojë gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur;
4. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
5. Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
6. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundravajtje penale me dashje;
7. Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore;

Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:

1. Të ketë përfunduar studimet e larta universitare dhe të zotërojë diplomë të nivelit Master Shkencor në Fakultetin Ekonomik;
2. Të ketë të paktën 1-2 vite përvojë pune në profesion;
3. Të ketë njohuri në gjuhën angleze; Njohuri kompjuterike në programet bazë të kompjuterit;
4. Të ketë aftësi menaxhuese, organizative, komunikuese si dhe punë në grup shumë të mira.

Adresa: Rruga "Marin Beçikemi", Sheshi "Gjon Pali II"

Tel, Fax : 02 2243409

DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT:

- Kërkesë motivimi për aplikim në vendin e punës që konkuron.
- Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:
- Jetëshkrim (CV);
- Fotokopje të diplomës dhe të listës së notave të noterizuara;
- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- Vërtetim të gjendjes gjyqësore;
- Çdo dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive, rekomandime apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e kandidatit.

Dokumentet duhet të dorëzohen në zarf pranë Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Shkodër brenda datës 19.07.2023.

Mosparaqitja e plotë e dokumentacionit sjell skualifikim të kandidatit.

Ankesat nga kandidatët e pakualifikuar paraqiten në DRTK Shkodër , brenda 2 ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual dhe ankuesi merr përgjigje brenda 2 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të saj.

REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK:

Në datën 21.07.2023, DRTK Shkodër do të shpallë në faqen zyrtare të DRTK Shkodër www.drtskshkoder.com, listën e kandidatëve, që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet vlerësimi profesional nga Komisioni. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta do të njoftohen përmes postës elektronike zyrtare e institucionit, për shkaqet e moskualifikimit.

FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA:

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

a) Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionin si dhe njohuritë mbi ligjin nr.10 296, datë 8.7.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”,

Adresa: Rruga “Marin Beçikemi”, Sheshi “Gjon Pali II”

Tel, Fax : 02 2243409

- ligjin nr.162/ 2020 “Për Prokurimin Publik;
- ligjin nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë;
- ligjin nr.9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, i ndryshuar së bashku me VKM-në e pagave;
- ligjin nr.35/2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administrates publike, si dhe të bazës në shkallë vendi” së bashku me VKM-në e pagave të punonjësve mbështetës;
- ligj nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, I ndryshuar;
- VKM nr. nr. 425, datë 27.5.2020 “Për procedurat e përzgjedhjes së subjekteve të pajisura me licencë për projektim, zbatim, mbikëqyrje dhe kolaudim në pasuritë kulturore, për kryerjen e investimeve me fonde publike në pasuritë kulturore”, i ndryshuar;

b. Eksperiencën e tyre të mëparshme;

c. Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE:

Kandidatët do të vlerësohen në bazë të testimit nga Komisioni sipas një sistemi pikëzimi.

Kandidatët do të testohen dhe vlerësohen nga Komisioni pranë DRTK Shkodër sipas pikëzimit:

- 40 (dyzet) pikë për njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës;
- 50 (pesëdhjetë) pikë për përvojën profesionale të mëparshme;
- 10 (dhjetë) pikë për motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për pozicionin e punës:

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, DRTK Shkodër do të shpallë fituesin në faqen zyrtare. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës së e-mailit, për rezultatet.

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURRIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT:

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, informacioni për fituesin do të shpallet në faqen zyrtare të DRTK Shkodër www.drtskshkoder.com.

Konceptuar: S. Kojë




Adresa: Rruga “Marin Beçikemi”, Sheshi “Gjon Pali II”

Tel, Fax : 02 2243409